



# PLATFORMA

*Me UT, për UT – Vizion dhe Integritet!*

# Kozeta Sevrani

*(Bylykbashi)*

**Plani i Veprimit UT**  
**2020-2024**

# JETËSHKRIMI

Prof. Dr. Kozeta Sevrani është pedagoge e informatikës në Universitetin e Tiranës që prej vitit 1984. Interesat e saj kërkimore përfshijnë: Sistemet e informacionit dhe Siguria e informacionit; e-qeverisje dhe e-shërbime; Integrimi i sistemeve të informacionit; Shkenca e të dhënave; Modelimi dhe Simulimi, etj.

Që nga viti 2010 është organizatore e konferencës ndërkombëtare vjetore “Information Systems and Technology Innovation – ISTI”, bashkë-organizatore e konferencave dhe workshop-eve të ndryshme.

Prof. Sevrani është përfshirë në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo është në bordin editorial të disa revistave ndërkombëtare dhe puna e saj është botuar në disa revista të njohura. Është bashkëautore e një monografie jashtë vendit si edhe e katër librave universitare. Ka disa eksperiencë në mësimdhënie në universitete të huaja si në Suedi, Austri, Norvegji, Kosovë, etj.

Gjithashtu, ajo është anëtare e bordit dhe e komisioneve në disa agjenci apo institucione qeveritare. Prof. Dr. Kozeta Sevrani është aktualisht Kryetare e Këshillit të Statistikave të Shqipërisë si dhe Kryetare e Komisionit të titujve akademikë të Universitetit të Tiranës.

# Tabela e Përmbajtjes

Fjala e Prof. Dr. Kozeta Sevrani 04

---

Vizioni 06

---

Misioni 06

---

Objektivat 07

---

I. Qeverisja 08

---

II. Infrastruktura 13

---

III. Mësimdhënia/Mësimnxënia 16

---

IV. Kërkimi Shkencor 21

---

V. Ndërkombëtarizimi dhe  
Digjitalizimi 25

---

VI. Sigurimi i Cilësisë 29

---

VII. Studentët 32

---

VIII. Financat 40

---

Me UT, Për UT  
**Vizion dhe  
Integritet!**



**Universiteti i Tiranës**



+355 68 204 4843



kozeta.sevrani@unitir.edu.al  
www.kozetasevrani.com

# FJALA E PROF. DR. KOZETA SEVRANI

***Të nderuar kolegë dhe studentë të UT-së,***



*Duke e konsideruar Universitetin e Tiranës institucionin elitare të krijimit dhe ofrimit të dijeve, promovimit të vlerave dhe përfaqimit të ideve inovative, vendosa të kandidoj për pozicionin e Rektorit të UT-së, me qëllimin, vizionin dhe bindjen për ta zhvilluar dhe forcuar më tej rolin dhe misionin që ky institucion ka në jetën shoqërore, kulturore dhe politiko-ekonomike të vendit.*

*E nisa rrugëtimin tim në vitin 1979 si studente pranë këtij universiteti, për të vijuar formimin akademik dhe profesional si Doktore në Informatikën e Zbatuar (1997), Profesore e Asociuar (2005) dhe Profesore (2011).*

*Ky zhvillim profesional dhe personal, është përfaqësim i vlerave morale, etike dhe shoqërore të familjes time, të cilat u përpoqa t'i kultivoj në variantin më të pastër tek të gjithë studentët dhe kolegët në 36 vite veprimtari akademike dhe shkencore pranë UT-së dhe institucioneve të tjera.*

*Departamenti "Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar" (FEUT), në krye të të cilit kam qenë për 10 vite, numëron deri më sot rreth 1500 studentë, nga të cilët rreth 100 janë bërë pjesë e programeve të këmbimit. Kjo ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të departamentit me universitete Europiane në 16 projekte ndërkombëtare, duke e bërë departamentin në fjalë ndër më të suksesshmit në UT.*

*Në vitet e fundit, angazhimeve të mia i janë shtuar detyrat si Kryetare e Këshillit të Statistikave të Shqipërisë dhe si Kryetare e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, i miratuar nga Senati i UT-së. Këto eksperiencë më kanë ndihmuar ta shikoj UT-në në një këndvështrim tjetër.*

*Universiteti i Tiranës, në historinë e tij më shumë se 60 vjeçare, ka ecur paralelisht me zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në vend, pa llogaritur zhvillimet teknologjike. Nevoja për t'u zhvilluar në kushtet e tregtisë së lirë dhe konkurrencës, e ka bërë Universitetin një institucion që i drejton përpjekjet e tij thjesht për t'u përshtatur më shumë sesa për të qenë prijës i inovacionit.*

*Ëndrra për t'u integruar në Bashkimin Europian ridimensionoi konceptin e pedagogëve, studentëve dhe vendimmarrësve në këtë fushë, për lirinë dhe autonominë akademike. Kjo u reflektua në disa zhvillime ligjore, organizative dhe institucionale që lidhen me Arsimin e Lartë në Shqipëri, por drejtimi i një universiteti duhet të shoqërohet me vizion dhe të shkojë përtej përmbushjes së standardeve, që të mund të ofrojë vlerë të shtuar dhe ekselencë.*

*Ju ftoj të gjithëve t'i bashkoheni platformës për drejtimin e UT-së me vizion dhe integritet, në mënyrë që të gjithë ju, pedagogë dhe studentë, të identifikoheni me universitetin tuaj, Universitetin e Tiranës, për të ndërtuar profilet personale dhe profesionale. Le të lartësojmë sëbashku vlerat e universitetit, një universitet që mbështet meritokracinë, ofron gjithëpërfshirje dhe diversitet, nxit kërkimin shkencor dhe motivon të talentuarit.*

*Platforma e propozuar për zhvillimin e UT-së përbën një draft, i cili do të marrë formë përfundimtare pas marrjes në konsideratë të sugjerimeve apo vërejtjeve të stafit akademik dhe mbështetës, studentëve, qytetarëve apo çdo strukturë tjetër publike ose private e interesuar për mbarëvajtjen e UT-së, si tempull i përgatitjes së brezave të ardhshëm. Në përfundim, kjo platformë nuk do të mbetet thjesht një premtim, por do të jetë plani konkret i punës nën drejtimin tim në 4 vitet e ardhshme. Ajo do të ndiqet nga kordinatorë të posaçëm për secilën nga tetë shtyllat e propozuara.*

*Ndaj sot, ndiej përgjegjësinë për të kandiduar,*

- ➔ *së pari për t'ju dhënë një alternativë për një të ardhme më premtuese,*
- ➔ *së dyti për t'u bërë të gjithë bashkë pjesë në krijimin e një institucioni elitar e bashkëkohor dhe*
- ➔ *së treti për të sjellë një ndryshim në mendësinë e drejtimit të UT për herë të parë nga një grua.*



# VIZIONI

Përkushtim në ofrimin e mundësive të barabarta, vecanërisht pa dallim gjinor, ku mirëqënia e studentit dhe stafit, si asetet më të vyera të institucionit dhe gjithë shoqërisë, garantohet përmes diversitetit, vlerësimit të drejtë dhe zhvillimit në karrierë.

# MISIONI

- Kontributi në shoqëri përmes mësimdhënies/nxënies dhe kërkimit shkencor në nivelet më të larta cilësore.
- Edukim që inkurajon studentët të shpalosin talentin dhe të orientojnë ambiciet e tyre për një të ardhme më të sigurt dhe shpresëdhënëse duke ju zhvilluar aftësinë e të mësuarit përgjatë gjithë jetës. Dhënie e prioritetit për studentët e grupeve të nën-përfaqësuar apo të disavantazuar. Pajisjen me dije dhe aftësi që të shfrytëzojnë më së miri potencialet, të njohin vlerat kulturore dhe etike në mënyrë që të përfaqësojnë vetveten si profesionistë të kualifikuar, të denjë e të përgjegjshëm për shoqërinë.
- Programe studimi me një gamë të gjerë të disiplinave ku lëndët akademike ofrojnë dije të thelluar, cilësore dhe të azhornuar me kohën për të lehtësuar konkurrencën dhe mobilitetin.
- Rritjen e aktiviteteve ekstra kurrikulare, për më shumë mundësi të rritjes së eksperiencave në fusha të interesit personal me karakter artistik, kulturor dhe sportiv, për ta lidhur studentin me institucionin, që në një të ardhme të identifikohet me vlerat e tij.
- Sistem i konsoliduar i kërkimit shkencor dhe inovacionit që do të adresojë vështirësitë dhe do të ofrojë zgjidhje për sfidat aktuale dhe të ardhshme, si dhe do të formojë në nivele të larta akademikët, kërkuesit shkencorë dhe shkencëtarët e ardhshëm.
- Bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar për të treguar impaktin pozitiv në ekonominë dhe shoqërinë Shqiptare që ka Arsimit i Lartë, si dhe për të kontribuar në ndërgjegjësimin e rëndësisë dhe përfitimeve të shkencës dhe aktivitetit shkencor për një shoqëri më të mirë.

# Objektivat



Objektivat do të arrihen nëpërmjet këtij plan veprimi, qëllimi i të cilit është rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe efektivitetit që ato kanë më tej tek studentët dhe produkti final në shoqëri.

Ky plan mbështetet në konsultime, jo vetëm të legjislativës, por dhe në arritjet e deritanishme, diskutime me studentë, përfaqësues të interesave të studentëve, stafin akademik dhe administrativ të UT, sigurisht duke synuar një veprimtari më fizibël që do të funksionojë në formën e një sistemi ku implementohen politika, të cilat monitorohen, vlerësohen dhe rishikohen, nëse është e nevojshme, për të siguruar përputhshmëri, përmirësim të vazhdueshëm dhe performancë të lartë.

Plani i Veprimit për mandatin 2020-2024 është ndërtuar në 8 shtylla kryesore, të cilat përbëjnë në vetvete objektivat ku do të punohet për zhvillimin e ardhshëm afatmesëm të universitetit. Ato ecin përputhje me Strategjinë e UT, Strategjinë Kombëtare për Shkencën dhe Inovacionin dhe paketën legjislative.



**I Qeverisja**



**II Infrastruktura**



**III Mësimdhënia/  
Mësimnxënia**



**IV Kërkimi Shkencor**



**V Ndërkombëtarizimi  
dhe Digjitalizimi**



**VI Sigurimi i Cilësisë**



**VII Studentët**



**VIII Financat**

*Këto do të sigurojnë që sistemi të jetë i qëndrueshëm dhe cilësor, si për studentët e rinj të cilët do të na besojnë edukimin e tyre dhe studentet e diplomuar të cilët do të konsolidojnë vlerat më të larta dhe dijet më bashkëkohore të formimit personal dhe profesional.*

# I Qeverisja

Autonomia e Universitetit do të thotë një ambient me integritet të lartë akademik, më konkurrues dhe më kreativ. Integriteti matet në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies. Por këto mund të arrihen vetëm falë forcimit të qeverisjes që është vendimmarrëse në manaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe akademike.

Autonomia e Universitetit duhet kuptuar si kontribut në objektivat kombëtare dhe shoqërore, pasi qëllimi i saj është forcimi i studentëve dhe lidhshëm në ardhshëm në standardet më përfaqësuese ndërkombëtare.

Për të krijuar një universitet cilësor nuk mjaftojnë vetëm elementët thelbësorë si autonomia dhe aftësia e tij për të menaxhuar burimet e veta në mënyrë që t'i përgjigjet shpejt kërkesave të një tregu që vazhdimisht është në ndryshim. Gjithashtu janë të nevojshëm elementë të tjerë të qeverisjes të tillë si:

- Vizioni i fortë strategjik i drejtimit institucional.
- Filozofia e suksesit dhe ekselencës.
- Kultura e reflektimit të vazhdueshëm, e mësimin nga organizata dhe e ndryshimit.

Brenda institucionit të UT-së, të gjitha strukturat qeverisëse (Rektori, Bordi i Administrimit, Senati, etj.) duhet të kenë mirëkuptim për parimet e qeverisjes dhe aplikimin e tyre. Këto parime synojnë:

## **Synimi**

### **1. Respektim të qëllimit të institucionit**

Autonomia si garancia më e mirë e cilësisë dhe reputacionit të Universitetit. Liria akademike dhe kërkimi shkencor, mobilitetet, bursat dhe mësimdhënia me cilësi të lartë.

### **2. Përkushtim ndaj interesave të palëve të interesuara**

Mbrojtja e interesit kolektiv të studentëve.

### **3. Transparenca**

Publikimi i informacionit të saktë dhe transparent që është i arritshëm për publikun.

### **4. Mosdiskriminim**

Arritja e barazisë së mundësive dhe diversitetit në të gjithë institucionin. Parimi që Arsimiti i Lartë duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë ata që janë në gjendje të përfitojnë prej tij.

### **5. Llogaridhënie**

Të sigurohet përgjegjësi e plotë dhe transparente për zbatimin e planeve të aktiviteteve mësimore / kërkimore shkencore të miratuara, si dhe përdorimin e fondeve publike.



# Plani i Veprimit

## I QEVERISJA

---

Qeverisja e mirë, e cila përpiqet të ruajë integritetin e sistemit të vlerave akademike, kërkon më shumë sesa thjesht krijimin e proceseve. Ajo ndërtohet në marrëdhënie të forta, dialog të ndershëm dhe respekt të ndërsjelltë.



NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
I.	<i>QEVERISJA</i>			
	Fuqizimi përmes leadership-it, mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit	Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi (Leadership)	Përmirësimi dhe /ose krijimi i politikave / rregulloreve /udhërrëfyesve që qartësojnë proceset vendim-marrëse dhe nxisin e promovojnë mekanizmat e bashkëpunimit midis të gjitha strukturave institucionale, përfshirë bordet dhe këshillat.	2021
			Rritja e autonomisë së Universitetit përmes rritjes së aftësive dhe mundësive për vetëgjenerimin e të ardhurave financiare.	
			Krijimi dhe miratimi i një kornize mbi promovimin e mos diskriminimit të çfarëdo lloj forme (gjinor, etnik, aftësi të kufizuara, etj.,) për të garantuar mundësi të barabarta si në punësimin e personelit edhe në pranimin e studentëve.	
			Krijimi i një sistemi të kujdesit dhe shërbimit shëndetësor, psikologjik dhe juridik për personelin e Universitetit të Tiranës.	
		Personeli	Ndërtimi i një sistemi që dokumenton të gjithë procedurën dhe procesin e rekrutimit të stafit, vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit, për të evidentuar stafin që ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm, që vlerësohet me kontribut në institucion.	2021
			Mundësi të barabarta për përzgjedhjen e grave në pozicione drejtuese akademike kërkimore.	2022

Krijimi i një mjedisi akademik ku promovohet liria, diversiteti, puna në grup dhe shpërblimi		Analizimi i nevojave për personel si bazë për planifikimin sasior të tij, për të përmirësuar e raportin pedagog/student, mbulimin e nevojave për udhëheqje të doktorantëve, plotësimin e nevojave për krijimin e profileve shkencore në kërkimin shkencor dhe rritjen e vizibilitetit ndërkombëtar të UT.	
		Zhvillimi i programeve të strukturuar të trajnimit për metodat në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, inovacionin, menaxhimin e projekteve dhe komercializimin për stafin akademik.	
	UT qendër ekselence kombëtare dhe rajonale	Rritja e numrit të kërkuesve shkencor kyç që janë personalite shkencore në fusha të caktuara të kërkimit.	
		Rritja e numrit të publikimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet krijimit të një kornize të qartë të mbështetjes financiare.	
		Inkurajimi, mbështetja dhe promovimi i revistave dhe konferencave shkencore në nivel fakulteti.	
		Inkurajimi, mbështetja dhe promovimi i punimeve shkencore si produkt i bashkëpunimeve ndërmjet fakulteteve të UT ose me partnerë të huaj.	
		Krijimi dhe mbështetja e inkubatorëve të inovacionit.	
		Publikimi në portalin Euraxess-Albania të gjithë vendeve të hapura të punës për personel akademik dhe kërkimor në Universitet, sipas udhëzimeve të Ministrisë.	
	Mobiliteti	Rritja me 20% e numrit të studentëve në programe të këmbimit (studim apo trajnim) jashtë vendit.	2024

			Forcimi i strukturave të posaçme për trajnimin dhe mbështetjen me ekspertizë të stafit akademik dhe studentëve mbi procedurat dhe mundësitë për mobilitetin në kuadër të projekteve të ndryshme ndërkombëtare.	
			Rritja me 20% e përfshirjes së diasporës shkencore në shkencë, teknologji, inovacion.	2022
			Rritja e vizitave akademike, experiencave të këmbimit, sabatikëve, granteve dhe pozicioneve të punësimit jashtë vendit.	
			Thjeshtëzimi i praktikave të punësimit për kërkues të huaj dhe lehtësimi i mobiliteteve, në zbatim të legjislacionit kombëtar mbi qëndrimin dhe punësimin e shtetasve të huaj në IAL.	
			Bashkëpunim maksimal për skemen e bursës "Studiuesi Vizitor i Diasporës" (Visiting Diaspora Fellowship).	
	Transparencë dhe Llogaridhënie	Transparencë dhe Llogaridhënie	Krijimi i mekanizmave dhe infrastrukturës për të mundësuar përfaqësimin dhe përfshirjen në proceset vendim-marrëse të të gjithë palëve të interesuara: Studentët, Pedagogët, Komunitetin Akademik dhe Aktorët në Tregun e Punës.	
Publikimi periodik i raporteve mbi zhvillimet kryesore në UT: Kërkimin Shkencor, Sigurimin e Cilsësisë në Mësimdhënie, Projektet në Zhvillim, etj.				
Publikimi periodik i raporteve financiare mbi shpenzimet në UT.				

# Plani i Veprimit

## II INFRASTRUKTURA

Universiteti i Tiranës, si universiteti më i vjetër dhe më i madh në vend, trunngu i madh prej të cilit janë shkëputur në kohë edhe dy universitete të tjera shumë të rëndësishme dhe unike për nga fushat e dijes që mbulojnë, është përballur me një numër të madh dhe gjithnjë në rritje të studentëve që i besojnë edukimin e tyre këtij institucioni.

Duke konsideruar që stafi dhe studentët janë aset kryesor i kapitalit njerëzor të Universitetit, hapësira infrastrukturore dhe lehtësitë e tjera fizike janë një pikë qendrore për të siguruar mjedisin në të cilin ata mund të shkëlqejnë. Po kaq të rëndësishme janë dhe bibliotekat apo lehtësi të tjera, mbështetja për kërkimin shkencor, për mësimdhënien dhe mësimnxënien, për menaxhimin e njohurive dhe burimet e informacionit dhe komunikimit. Thelbësore për nga rëndësia janë platformat e nevojshme për të mbështetur aktivitetet e prodhimit të njohurive dhe ndërlidhjet e institucionit mes fakulteteve përbërëse apo me institucione të tjera, të cilave do t'i kushtohet vëmendja e duhur.

UT do të vazhdojë të mbështesë dhe nxisë zhvillimet infrastrukturore dhe realizimin e objektivit të hershëm (12 vjeçar) të kampusit universitar duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse në lidhje me zgjerimin fizik të të gjithë fakulteteve përbërëse të UT-së.

Objektivi lidhur me këtë synon ofrimin e një infrastrukture moderne dhe inovative, ku stafi dhe studentët të kryejnë veprimtarinë e tyre në kushtet më të mira të kohës, për arritjen e qëllimeve akademike personale, profesionale, universitare dhe kombëtare.



NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
<b>II. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA</b>				
	Krijimi i hapësirave të përshtashme universitare për sigurimin e përvetësimit të dijeve në praktikë dhe në koherencë me zhvillimet më të fundit	Mjediset Universitare	Zgjerimi i hapësirave për zyra, salla leksioni, laboratorë dhe biblioteka, me qëllim përmirësimin e raportit të sipërfaqes për student dhe pedagog, si dhe të kushteve të punës, mësimdhënies dhe studimit.	
			Planifikimi dhe menaxhimi i procesit të përmirësimit të infrastrukturës së laboratorëve, bibliotekave dhe arkivave të UT.	
			Përmirësimi i infrastrukturës së UT për të garantuar hyrjen në ambjentet e UT për personat me aftësi të kufizuara.	
			Të arrihet që në çdo fakultet të ketë me tepër se një sallë amfiteatri sipas standardeve moderne dhe me rinovimet periodike të teknologjisë, që të funksionojë me kapacitet të plotë së paku për 12 orë në ditë.	
			Sigurimi për çdo fakultet i një salle studimi me kompjutera të lidhur në internet dhe me rinovimet periodike të teknologjisë, që të funksionojnë për të konsultuar bibliografinë nga ana e studentëve me funksionim të plotë së paku për 12 orë në ditë.	
			Krijimi për çdo fakultet i një ambienti të dedikuar për realizimin e konferencave dhe videokonferencave me të gjithë parametrat audioviziv dhe elektronik të domosdoshëm.	

		Krijimi i hapësirave relaksuese, rekreative dhe sportive për studentët dhe stafin akademik.	
	Laboratorët	Laboratorët në përputhje me politikat e European Strategy Forum of Research Infrastructure and European Research Area, të akredituara pranë institucioneve të posaçme.	2020-2022
		Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor dhe ambienteve të nevojshme të punës (përfshirë pajisjet) për secilin kërkues shkencor/doktorant.	2022
	Biblioteka	Krijimi i një biblioteke qendrore universitare të UT-së.	
		Bashkëpunim me Qëndren Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar për sjelljen në jetë të projektit për Bibliotekën Elektronike.	
		Garantimi i aksesit të hapur online për të gjitha botimet shkencore të financuara me fondet publike apo të zhvilluara në UT.	2020
		Literaturë fizike dhe pajisje teknike me programe kompjuterike, për shfrytëzim të paktën 12 orë në ditë nga studentët.	
		Pasurimin e zërave të bibliotekës dhe manaxhimin e fondit për të.	Në vazhdimësi

# Plani i Veprimit

## III MËSIMDHENIA DHE MËSIMNXËNIA

---

Qëllimi i procesit mësimor në nivel universitar është krijimi i kapaciteteve sociale apo studentë që kanalizojnë talentet dhe pasionet e tyre në fusha ku shfrytëzohet maksimalisht potenciali në mendimin strategjik dhe kritik, sipërmarrës dhe kreativ.

Për të arritur këtë objektiv, programet e studimit duhet të përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme sipas kërkesës së tregut dhe dinamikës së zhvillimit kulturor, social dhe ekonomik.

Gjithashtu metodat e mësimdhënies dhe kualifikimi i stafit akademik duhen përmirësuar në vijimësi për të siguruar mësimnxënie efektive.





NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
<b>III. MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA</b>				
	Kurrikula dhe Programe Studimi që sigurojnë cilësi të lartë në standarte bashkëkohore dhe reflektojnë kërkesat e tregut të punës duke ofruar mundësi për kanalizimin e talentit dhe pasionit në fushat më produktive në aspektin social dhe ekonomik	Përshtatshmëria e programeve të studimit me kërkesat e studentëve, kapacitetin intelektual dhe tregun e punës	Rishikimi i të gjitha programeve të lëndëve dhe planeve mësimore me qëllim lehtësimin e tyre, zhveshjen e tyre nga lëndët e përgjithshme dhe drejtpeshimi më i mirë mes ngarkesës mësimore në auditore dhe punës të pavarur të studentëve. Përafrimin e planprogrameve me shembuj të Universiteteve me një rankim të lartë.	Brenda tre viteve të para të punës
			Përditësimin e literaturës së planprogrameve dhe Kurrikulave në mënyre që programet e studimit të reflektojnë ndryshimet e kohës, të jenë praktikë dhe të sigurojnë sukses për të diplomuarit në një mjedis dinamik.	2021
			Rishikimi i planeve mësimore me qëllim rritjen e përqindjes së lëndëve me zgjedhje për t'u mundësuar studentëve variante më të përshtatshme për kërkesat e tregut të punës.	2021
			Harmonizimi, në programet profesionale që organizojnë studime mbi profesione të rregulluara me ligj, mes dijeve të marra gjatë programit të studimeve profesionale dhe dijeve për të cilat kandidatët testohen në provimin e licensimit.	2023
			Rritjen e numrit të stafit akademik, ndihmës akademik dhe jo akademik në pjesëmarrjen në kurse të trajnimit për proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies.	2022
			Rritjen e numrit të seminareve/workshop-eve/forumeve për këmbimin e eksperiencave më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënie.	Brenda vitit të parë të punës
			Rritjen e numrit të studenteve me rezultate të shkëlqyeshme	2022

		Përcaktimi i këshilltarëve të studimeve për çdo kurs studentësh me qëllim mundësimin e tutorimit dhe udhëheqjes më të mirë të studentëve gjatë periudhës së studimeve.	2021
		Parashikimi i një koordinatori për çdo program studimesh, i cili ka kompetenca që duhet të përcaktohen në nivel universiteti dhe në përputhje me rregulloren e UT dhe rregulloren e programit përkatës të studimit.	
	Implementimi i trendeve të momentit që ndikojnë në rritjen e performancës së mësimdhënies dhe mësimnxënies	Ofrimi i ambienteve "smart" në procesin e mësimdhënies si prezantime wireless, pajisje të ndërlidhura me pajisjet e tjera të fakultetit, aksesim të një baze të dhënash të unifikuar dhe të aksesueshme në bazë të profilit dhe të drejtave të përdoruesit, internet i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e regjistruar në databazën e unifikuar të çdo fakulteti.	
		Organizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare për identifikimin e studentëve ekselent dhe të prirur në drejtime të ofruara nga Universiteti i Tiranës si dhe hulumtimin, mbështetjen e stimulimin e kësaj ekselence me anë të stafit akademik dhe rrjetit të bashkepunimit me bizneset dhe institucionet qeveritare.	
		Trajnimin e stafit akademik për kultivimin e empatise dhe inteligjences sociale si një nga elementët nxitës të mesimnxënies, përfshirjes së studentëve në procesin e mësimdhënies si dhe krijimit të atyre që njihen me termin soft skills (përshtatje: soft skills janë aftësi jo teknike si mendimi kreativ, puna në grup, menaxhimi i kohës dhe afateve kohore, fleksibiliteti, aftësitë komunikuese etj.)	

Zgjerimi i target grupeve të studentëve të Universitetit të Tiranës duke synuar ofrimin e masterave ekzekutivë për të gjithë të punësuarit në institucione qeveritare apo sektorin privat	Rritja e bashkëpunimit midis Universitetit të Tiranës dhe tregut të punës dhe industrisë duke krijuar ura komunikimi dhe procese ndërkombëtare informacionesh dhe feedbacku për studimet master.	
	Kontribut direkt në rritjen profesionale të forcës punëtore brenda vendit kjo pasi studentët e masterit ekzekutiv ndryshe nga studentët e masterave shkencorë dhe profesional janë punonjës të institucioneve dhe shoqërive brenda vendit.	
	Ofron forcimin e pozitive strategjike të Universitetit të Tiranës në vend duke qënë një nga të paktët universitete që ofrojnë Mastera Ekzekutivë.	
	Ndikon pozitivisht në terma marxhinale në buxhetin e Universitetit të Tiranës pasi tarifa e maserave ekzekutivë është me e lartë se ajo e masterave shkencor dhe profesional.	
Gjuha e Huaj (Anglisht) si faktor ndërkombetarëzi mi	Ofrimi i versionit në anglisht të faqes së internetit të Universitetit. Të shtohet seksioni ku studentët të kenë mundësi të gjejnë informacione dhe mbështetje me qëllim që të zgjedhin programin e duhur të studimit dhe seksioni ku studentët të mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshem për organizimin e udhëtimit dhe të qëndrimit në Shqipëri.	
	Përgatitja e dokumentacionit në gjuhë të huaj për planet mësimore dhe diplomat e lëshuara nga UT.	
	Krijimi i një programi formimi ndërkombëtar në gjuhë të huaj për programet e studimit më shumë të kërkuara nga studentët e huaj dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të UT.	
	Sigurimi i aksesit në një bibliotekë universitare të huaj, fond librash me autorë të huaj dhe krijimi pranë çdo Fakulteti i fondit të librave digjitalë në gjuhë të huaj.	

	<p>Shkolla verore dhe dimërore si mënyra më e mirë për përmirësimin e performancës akademike dhe marrëdhënies me universitetin</p>	<p>Kurse konkrete (tipikisht lëndet me zgjedhje të programeve të studimit në UT) të shprehura në kredite të transferueshme, me pjesëmarrje të studentëve dhe profesorëve nga rajoni dhe bota.</p>	<p>2021 - Në vazhdimësi</p>
--	--	---	-----------------------------

# Plani i Veprimit

## IV KËRKIMI SHKENCOR

Kërkimi shkencor është e vetmja veprimtari që mund të zhvillojë dijet njerëzore në nivelin e duhur për maksimizimin e mirëqënies sociale dhe ekonomike. Influenca e një produkti të kërkimit shkencor (ide/teori/koncept) shtrihet në një gamë të gjerë (njerëz/veprimtari). Universiteti është vendi ku kërkimi shkencor duhet të zëri një pjesë shumë të rëndësishme të veprimtarisë së tij si dhe me një ndikim të gjerë në shoqëri.

Për shumë kohë fokusi i kërkimit shkencor ka qenë arritja e një objekti personal, pa u shqetesuar shumë për efektin, kontributin apo përfitimin nga ky kërkim.

Plani synon arritjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare por mbi të gjitha vlerën e shtuar në aspektin moral dhe intelektual.



NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
<b>IV. KËRKIMI SHKENCOR</b>				
	Kërkim Shkencor i standarteve më të larta bashkëkohore, lider në kerkimin shkencor në vend, me përfaqesimin e gruas në nivelet më të larta në historikun e universitetit, duke rritur autonomine dhe transparencën e fondeve për kërkim si dhe duke rritur vetëdijesimin mbi rëndësinë e kërkimit shkencor strategjik që gjeneron pronësi intelektuale.	Rritjen e financimeve, kapacitetit dhe infrastrukturës për te kryer aktivitete të kërkimit shkencor dhe për ta bërë UT institucionin lider në këtë drejtim në kushte të konkurrencës	Aplikimi pranë AKKSHI, AKFAL për projekte kombëtare të kërkim zhvillimit sipas percaktimeve dhe afateve kohore.	Brenda 3 mujorit te pare te cdo viti.
			Rritja e numrit të studenteve performues të ciklit të dytë që zgjedhin të vijojnë studimet e ciklit te tretë po në UT	2020-2024
			Incentiva për kërkues shkencor, doktorant dhe profesorë, lektorë për rritjen e numrit të publikimeve; publikime të artikujve në revistat më prestigjioze të indeksuara	Në vazhdimësi
			Botimi i revistave shkencore në nivel universiteti dhe jo vetëm fakulteti, duke konceptuar dy ose tre tituj revistash shkencore me për review, open sources dhe online, etj, që të bëhen referenca të mendimit shkencor kombëtar.	2020-2024
			Organizimi i konferencave shkencore në nivel universiteti me përfaqësim dhe organizim ndërkombëtar sipas tematikave të përzgjedhura nga propozimet e fakulteteve dhe departamenteve.	Në vazhdimësi
			Krijimi i rrjeteve kërkimore brenda fakulteteve dhe universitetit me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit ndër-fakultativ dhe ndërdisiplinor të personelit akademik	2020-2024
			Sigurimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor në UT për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë, shkencat e materialeve, ICT, albanologjisë.	2020-2024
				Arritjen e raportit 7 kërkues shkencor në 1000

Kërkim shkencor i standardeve Europiane me fokus barazine gjinore	Arritjen e përfaqësimit në masën 30% te kërkueseve shkencore femra dhe doktoranteve femra në fushat me prioritet kërkimi	2022
	Inicimin e doktoraturave dhe projekteve "Best Woman in Science".	2021-2024
	Angazhim maksimal, sëbashku me kordinatoren per barazine gjinore, për të qene më të mirët në mbështetjen e grave dhe për ta bërë UT te parin universitet që merr cmimet "Champion Woman Promotion in Science", Cmimin e Karrierës së Gruas Shkencetare dhe Cmimin e Kërkueseve të Reja	2021-2024
	Rritja e pjesëmarrjes në Programin Kombëtar të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit H2020	Në vazhdimësi
	Pjesëmarrje aktive dhe angazhim në iniciativat Open Science të Komisionit European dhe Grupin e Punës Open Science të Keshillit te Bashkepunimit Rajonal	2020-2024
	Pas marrjes së trajnimit të nevojshem nga AKKSHI për HR4 Excellence, nisjen nga puna per përgatitjen e dokumentave te nevojshme për aplikim	2021-2024
	Rritjen e fondeve totale dhe numrit të kërkuesve shkencor financiar nga sektori privat apo ndërkombetar që shfrytëzon infrastrukturen e UT	Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesve shkencore dhe biznesit përmes identifikimit të subjekteve me interes të veçante dhe hartimit të projekteve të përbashkëta që do të mundësojnë aplikimin me projekte kërkimore. Konkretisht rritjen e numrit te doktoranteve dhe stafeve akademike që behen pjesë e këtyre projekteve dhe përfitojne nga fonden qe alokohen ne kete kuader.
	Rritjen e bashkëpunimit me organizata ndërkombetare të huaja apo përfaqësi diplomatike të huaja për projekte kërkimore me interes gjeopolitik dhe ekonomik. Konkretisht rritjen e numrit	Në vazhdimësi

		te doktoranteve dhe stafeve akademike qe bëhen pjese e këtyre projekteve dhe përfitojne nga fonden qe alokohen në këte kuader.	
		Krijimi i instituteve ose organizatave jofitimprurëse nga Universiteti i Tiranës me financime të drejtpërdrejta publike ose private.	2020-2024
	Sigurimin e aksesit dhe transparencës së kërkimit shkencor	Garantimi i aksesit online për të gjitha botimet e financuara nga UT ose në bashkëpunim. Garantimi i aksesit për marrjen e informacionit mbi rezultatet e kërkimit shkencor dhe përdorimi i pakushtëzuar i të dhënave.	2020-2024
	Pronësia Intelektuale	Struktura të posacme pranë instituteve dhe qendrave të kërkimit shkencor për mbulimin e aktiviteteve te transferimit të teknologjisë së informacionit dhe për informimin mbi Pronësinë Intelektuale dhe Industriale.	2020-2022
		Përcjelljen e kërkimit shkencor strategjik, që është I aftë të gjenerojë PI, drejt komercializimit, në kuptimin qe të mund të sigurojë te ardhura	2020-2024
	Rritjen e komercializimit të kërkimit shkencor	Ndërgjegjësimi i opinionit publik dhe institucioneve vendimmarrëse mbi rëndësinë e kërkimit shkencor, inovacionit dhe transferimit të teknologjisë përmes organizimit të veprimtarive informuese mbi rëndësinë e veprimtarisë shkencore dhe inovacionit për bizneset, fermerët, opinionin e gjerë publik	2020-2024
		Negocimi, promovimi dhe reklamimi I mundësive të financimit të kërkimit shkencor nga sektori privat dhe ndërkombetar	2020-2024
		Promovimin dhe reklamimin e proukteve të kërkimit shkencor, vlerësimin e të ardhurave krijuar nga kjo. Rritjen e dijeve mbi komercializimin e kërkimit shkencor nga kërkuesit shkencor.	2020-2024



# Plani i Veprimit

## V NDËRKOMBËTARIZIMI DHE DIGJITALIZIMI

Teknologjia është gjykuar në këtë plan si instrumenti kryesor për standarde të larta akademike, por gjithashtu dhe kualifikimi i stafit akademik, studentor, zhvillimi i programeve të përbashkëta studimi, si dhe bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar, luajnë një rol të rëndësishëm në mënyrë që të gjithë aktorët të përfitojnë maksimalisht sipas pritshmërive personale objektive.

Ndërkombëtarizimi duhet kuptuar si një proces i vazhdueshëm prej të cilit këmbimi i vlerave do të sjell shtimin e tyre. Në strategjinë tonë zë një vend të rëndësishëm shkëmbimi ndërkombëtar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe promovimi i bashkëpunimit me universitete dhe partnerë të tjerë në të gjithë botën, të cilat bashkë me një bazë të mirë marketimi do e bëjnë UT më konkurrues dhe do e ngjisin atë në rankimin botëror. Ne synojmë ta arrijmë këtë duke:

- inkurajuar dhe mbështetur lëvizjet ndërkombëtare për studentë, staf pedagogjik dhe administrativ,
- promovuar dhe mbështetur bashkëpunimet ndërkombëtare dhe veprimtaritë kërkimore në nivel ndërkombëtar,
- krijuar dhe zgjeruar konceptin e shkollave verore dhe dimërore dy gjuhëshe (shqip dhe anglisht/gjermanisht/italisht/frëngjisht),
- nxitjen e studentëve dhe kandidatëve doktorant për të përfunduar diplomën apo semestre të ciklit të tyre të studimit në universitet ndërkombëtare.



NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
<b>V. NDËRKOMBETARIZIMI DHE TEKNOLOGJIA</b>				
	Zgjerimin e marrëveshjeve dypalëshe për shkëmbim studentësh dhe pedagogësh me universitete të huaja prestigjioze për të përfituar eksperiencë nga praktikantët me të mira botërore dhe të rritur vlerat e mësimdhënies/nxënies	Shtrirjen e veprimtarisë së UT përtej kufinjve	Tërheqja e studentëve ndërkombëtar përmes promovimit të programeve të studimit në UT.	
			Ngritja e një regjistri dhe e një sistemi online për studentët e huaj që vijnë në UT përmes programit Erasmus.	
			Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet institucioneve ndërkombëtare dhe lokale për organizimin e programeve të mobilitetit.	
			Rritja e financimit deri në 20% krahasuar me 5 vitet e fundit në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor.	2022
			Përfshirja e UT në veprimtaritë e koordinuara për angazhimin e përfaqësuesve kërkues e studiues të diasporës.	
			Pjesëmarrje aktive në platformën AlbScience-Diaspora (ALBSDI).	
		Rritjen e vizibilitetit të UT në sektorin e jashtëm	Pjesëmarrjen në ekspozita ndërkombëtare për edukimin.	
			Rritjen e numrit të bashkëpunimeve me universitetet e vendit dhe ato të huaja	
			Rritjen e njohjes së partneritetit strategjik me vendet e huaja dhe agjencitë ndërkombëtare.	

		Krijimi i programeve të përbashkëta të studimit me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.	
		Realizimi i njohjes së dyfishtë të diplomave me universitete të huaja partnere.	
	Rritjen e eksperiencave pozitive të studentëve ndërkombëtar	Aktivitete për inkurajimin e ndërveprimit të studentëve nga kultura të ndryshme me komunitetin vendas.	
	Shtimin e eksperiencave të huaja për stafin e UT dhe e anasjellta	Rritjen e mundësive për trajnimin dhe zhvillimin e stafit akademik jashtë vendit, për ta pajisur me instrumenta më bashkëkohor, që përforcojnë jo vetëm marrëdhënien me studentin por dhe produktin pas diplomimit.	
		Rritjen e numrit të profesorëve që këmbëjnë eksperiencë jashtë si dhe profesorëve të huaj që vijnë në Shqipëri.	
	Digjitalizimi dhe Teknologjia si mjete për tejkalimin e kufizimeve gjeografike e mëtej sociale, kulturore dhe edukative	Transformim digjital dhe investim në rrjet për të ofruar metoda studimi me fleksibël në një ambient digjital bashkëkohor, ku mësimdhënia përdor teknikat më të fundit për transmetimin e informacionit dhe dijeve.	
		Pajisja e sallave të leksioneve të të gjitha fakulteteve me infrastrukturën e transmetimit të informacionit numerik ardhur nga interneti si edhe instalimi i podiumeve përkatëse për kompjuter të lidhur në internet dhe me projektor për ekran muri.	
		Përmirësimi i cilësisë dhe shpejtësisë së internetit në të gjitha godinat e Universitetit. Lidhja nëpërmjet Wi-Fi të jetë funksionale në të gjitha mjediset universitare dhe të kenë	

			<p>akses në të edhe studentët sipas kodeve sekrete dhe fjalëkalimeve personale.</p>	
			<p>Krijimi i hapësirës numerike virtuale për çdo student në portalin web të Universitetit të Tiranës duke krijuar shërbimin e menaxhimit digjital të marrëdhënieve midis pedagogëve dhe studentëve, midis administratës, sekretarive mësimore dhe studentëve, midis vetë studentëve, etj. Në këtë hapësirë virtuale, çdo studenti do t'i vijë njoftimet administrative, programet e lëndëve, leksionet etj. Për këtë qëllim krijohet rrjeti i menaxherëve digjitalë të UT-së.</p>	

# Plani i Veprimit

## VI SIGURIMI I CILËSISË

Sigurimi i cilësisë është një koncept që u prezantua në ligjin e 2015 për arsimin e lartë dhe u konsolidua me kodin e cilësisë në vitin 2018.

Në vetevete ai është një proces që synon maksimizimin e experiencës mësimore për të arritur, përvetësuar dhe përmirësuar dijen dhe kulturën.

UT do të ketë në fokus të vet ngritjen, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Dy janë objektivat kryesore në sigurim e cilësisë së brendshme:

- të përballojmë me sukses kërkesat për akreditime, rankime, licencime bazuar në legjislacionin në fuqi.
- rritja e standarteve për ta kthyer UT-në një qëndër ekselence të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.



NR	STRATEGJIA	PLANI/PROGRAMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË</b>				
	Përcaktimi i treguesve të cilësisë për sa i përket mësim, programeve, kërkimit shkencor, problematikave të studentëve, etj.	Zbatimi i gjithë kuadrit ligjor	Sigurimin në mënyrë periodike që programet e studimit dhe institucioni në tërësi janë në përputhje me standartet e cilësisë dhe Kodin e Cilësisë përmes ngritjes ose forcimit të strukturave të posacme pranë cdo njësie kryesore.	Cdo vit
		Adresimin dhe zgjidhjen e problemeve/ ankesave të studentëve dhe stafit	Kryerjen e monitorimit, vlerësimit dhe marrjen e masave, për të gjithë programet e studimit, për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e cilësisë.	Cdo vit
			Ngritjen e njësisë së posacme për ndjekjen e ankesave të studentëve në shërbim të cilësisë dhe transparencës për zgjidhjen e problemeve, kjo përmes angazhimit të Kujdestarit të Studentëve, i cili është pedagog në fakultet dhe zgjidhet ekskluzivisht nga këshilli I studentëve me një mandate 2-vjeçar.	Cdo vit
		Infrastruktura dhe kapacitete cilësore të kërkimit shkencor	Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor bazuar në nivelin e kualifikimit të udhëheqësve shkencor dhe kërkuesve.	Cdo vit
			Sistemi i vlerësimit për çdo nivel kualifikimi të personelit akademik dhe doktorantëve do të bazohet mbi meritokracinë e matur me cilësinë e studimeve të kryera si dhe performanca të tjera akademike. Në këtë proces, Universiteti i Tiranës harton Kodin e Etikës dhe parashikon masa për respektimin e parimeve etike në mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si dhe parandalimin e plagjiazimit.	Cdo vit
			Krijimi i një baze të dhënash rreth kërkimit, inovacionit dhe transferimit të teknologjisë në UT në përputhje me indikatorët kombëtarë e ndërkombëtarë.	Cdo vit

			Përmirësimi në vazhdimësi i elementeve të planeve mësimore të lidhur me kërkimin shkencor, inovacionin dhe teknologjinë, dhe krahasimi me metodologjinë rajonale të matjes së cilësisë së tyre.	Cdo vit
		Transparenca mbi nivelin e cilësisë së UT	Raportet e cilësisë, ku përfshihen vlerësimi, plani i masave dhe studimi i impaktit apo efektivitetit të veprimtarisë lidhur me manaxhimin e cilësisë, do të bëhen publike për të gjitha grupet e interesit.	Cdo vit

# Plani i Veprimit

## VII STUDENTËT

---

Universiteti nuk do të kishte kuptim pa studentët. Ata janë themeli i cdo veprimtarie në UT. Synimi ambicioz është që Universiteti i Tiranës të bëhet shembulli më përfaqësues i Edukimit të Lartë në vend, arritje e cila është e konceptuar përmes angazhimit akademik dhe social, ekselencës, rritjes së cilësisë së kërkim-zhvillimit si dhe përmes të gjithë shërbimeve të tjera që Universiteti duhet dhe mund të ofrojë kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht.





Aspekt i rëndësishëm i formimit studentor, krahas atij akademik, është formimi mendor, karakterial dhe etik. Ligji për Arsimin e Lartë e ka rregulluar me dispozitë të vecantë këtë veprimtari (përmes Qendrës së Rekreacionit). Gjithsesi funksioni i saj duhet shtrirë, për t'iu dhënë mundësi të gjithë studentëve që përgjatë kohës inefektive që shpenzojnë në universitet, të zhvillohen edhe si individ me vlera të larta morale, të disjplinohen për përgjegjësitë familjare, komunitare, kombëtare dhe shoqërore.

Në mënyrë që çdo i diplomuar të këtë vlerat e kërkuara për punësim, UT merr përgjegjësinë të sigurojë që çdo student të formohet për të asimiluar cilësitë dhe karakteristikat për të qene i aftë, për të patur avantazhin konkurrues dhe për të shtuar vlerat në komunitetet profesionale dhe më gjerë.

Marrëdhënia me industrinë nënkupton tërësinë e lidhjeve që universiteti krijon me sektorin publik dhe privat, organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse.

Kjo marrëdhënie e dyanshme merr rëndësi të vecantë sepse universiteti nga njëra anë ofron forcën punëtore të së ardhmes, të aftë në nivel që ti përgjigjet tregut dhe punësimit, ndërkohë nga ana tjetër biznesi (përfshirë këtu çdo veprimtari ekonomike-sociale pavarësisht fitimit) bëhet në një farë mënyre përcaktues i programeve ku universiteti vendos të kanalizohet. Në këtë formë të dyja palët kontribuojnë në bashkëpunimin komunitar dhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Një pjesë e rëndësishme e këtij plani i dedikohet dhe sipërmarrjes, e konsideruar si çelësi i zhvillimit të një vendi. Formimi i studentëve në këtë aspekt që në nivelin universitar do të ofrojë një kapital human lider, të talentuar, inovator që do të ketë vetëbesimin për të marrë përsipër mundësi të reja dhe sfiduese.

Zhvillimet e fundit teknologjike në komunikim dhe internet e kanë orientuar individin drejt një nevoje për të përmbushur detyrat në mënyrë të pavarur. Propozimi për platformën e-Learning, është një tentative për të ofruar këtë pavarësi që në universitet, duke siguruar akses të barabartë dhe të drejtë për të gjithë dashamirësit e dijes si dhe duke krijuar një rrjet më transparent, të përgjegjshëm dhe të besueshëm lidhjeje profesor-student, ndërveprim më të lartë studentor ndërmjet njëri-tjetrit dhe botës.

Lifelong Learning (LLL) është një tjetër fushë e zhvillimit dhe edukimit, krahas atij akademik dhe profesional, e cila merr në konsideratë faktin që faktorë të ndryshëm social-ekonomik-demografik ndikojnë në vendimin për vijimin e shkollimit apo bëhen pengesë për tu futur në tregun e punës.

Zhvillimi i aftësive dhe dijeve për grupe të caktuara, veçanërisht nëpërmjet kurseve verore, edukimit fleksibël apo në distancë, mund të zgjerojë perspektivën për të ardhmen e çdo të riu.

NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
VII.	<i>STUDENTËT</i>			
	Sigurimin e pjesmarrjes aktive të studentëve në aspektin akademik dhe social;  Rritjen e kontributit monetar dhe jomonetar nga bashkëpunimi Industri-Universitet në fushat me përfitim për studentët;	Angazhimi Akademik	Sigurimi që studentët të diplomohen brenda periudhës së parashikuar për programin e zgjedhur të studimit. Zhvillimin e alternativave për reduktimin e mundësive që programi i studimit të tejkalojë periudhën 3/3+2 vjecare.	
			Verifikimin e zbatimit të ligjit sa i takon përfaqësimit të studentëve në Senat dhe Këshillat e Përhershëm, njëkohësisht duke verifikuar organizimin dhe funksionimin e Keshillave Studentorë.	
	Ndjekjen e studentit deri në daljen dhe integrimin në tregun e punës;  Formimin e studentëve që plotesojnë nevojat e tregut dhe krijojnë avantazhe konkurruese duke	Angazhimi Social	Promovimi i arsimit të lartë dhe avantazheve të studimit në UT nëpërmjet këshillave studentorë të fakulteteve përkatës, tek nxënësit e shkollave të mesme apo kolegjeve për të promovuar pjesëmarrjen e tyre në arsimin e lartë, pranë UT.	
			Zgjerimi i pjesëmarrjes të studentëve nga UT dhe promovimin e vlerave në aktivitete vullnetare për shoqërinë.	
			Shqyrtimi i mekanizmave që zhvillojnë kapacitetin e studentëve për të udhëhequr projekte rreth temave të drejtësisë sociale.	
			Organizimi i konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe aktiviteteve të tjera shkencore që synojnë jo vetëm përfshirjen e studiuesve dhe studentëve, por që i adresohen edhe publikut të gjerë.	
			Organizimi i aktiviteteve kulturore në bashkëpunim me institucione të ndryshme dhe ambasadat e huaja në Shqipëri.	
			Rritjen e aktiviteteve filantropike të cilat do të jenë pjesë e programit për t'i ardhur në ndihmë komuniteteve në nevojë.	

<p>kultivuar pasionet dhe hobet;</p> <p>Promovimin e vlerave më të larta sociale;</p> <p>Forcimin dhe zgjerimin e sistemit për mësimdhënien mbi sipërmarrjen.</p>		Promovimin e mundësive për edukim universitar të studentëve të cilët janë pjesë e popullatës së disavantazuar dhe nënpërfaqësuar.	
		Luajtja e një roli aktiv për mbrojtjen e mjedisit, kujdesin shëndetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm përmes projekteve në këtë tematike.	
		Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe të UT me institucione dhe agjenci të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim hartimin e analizave të ndryshme të cilat do të ndihmojnë politikë-bërësit për përmirësimin e jetës në Shqipëri dhe hartimin e politikave me ndikim në fusha të ndryshme.	
		Monitorimin e vazhdueshëm që përbërja e trupës studentore në cdo kohë, të mos reflektojë paragjykime të prejardhjes social-ekonomike të studentit.	
	Bashkëpunimi me Industrinë (Smart Partnership)	Rritjen e të ardhurave të UT nëpërmjet projekteve të konsulencës për bizneset.	
		Përfshirjen e punonjësve të kompanive në aktivitetet akademike.	
		Krijimin e mundësive dhe inkurajimin e stafit akademik/studentëve për tu bërë pjesë e programeve të bizneseve.	
		Nënshkrimin e marrëveshjeve me biznesin, institucione shtetërore (psh AKKSHI) apo institucione të pavarura (psh UNDP) për projekte të përbashkëta kërkimore shkencore në fushat që janë me prioritet për vendin.	
	Përshtatshmëria e Diplomave, Gjurmimi i	Studimin e tregut të punës, duke konsideruar impaktin e faktorëve social-ekonomik-demografik tek studentët e diplomuar për të adresuar problematikat e punësimit të tyre.	

Studentëve dhe Punësimi	Diversifikimi i praktikave pranë institucioneve publike dhe private ku zhvillohen praktikat mësimore të parashikuara në planet mësimore të programeve të studimit.	
	Ndërtimin e një databaze që do të mbledhë, analizojë dhe përdorë të dhenat e të diplomuarve për ti orientuar ata sa më drejt në sektorët më me perspektivë.	
	Gjurmimin e studentëve që emigrojnë për qëllime studimi/punësimi, për të patur një bazë të dhënash "alumni" dhe "mobilteti" të krahasueshme me vendet që kanë eksperiencat më të mira	
	Ndjekjen e Vendimeve të Këshillit të Ministrave që lidhen me punësimin e studentëve në administratën shtetërore (Ministritë, Institucionet Qëndrore, Bashkitë, Këshilli Kombëtar i Rinisë, Këshilli Vendor i Rinisë, organizatat rinore kombëtare por dhe ndërkombetare) si dhe vendimet që lidhen me praktikat mesimore po në këto institucione. Partneriteti me sektorin privat për të siguruar praktika mesimore për të gjithë të diplomuarit.	
	Zbatimin e Projektit GRADUA, për të përmirësuar kapacitetet e universitetit bazuar në praktikat më të mira Europiane.	
	Përfshirjen e UT-së në programin Digital Opportunity Trainingships përmes trajnimeve të Erasmus+.	
	Rritjen e numrit të studentëve të diplomuar që arrijnë të sigurojnë një pozicion pune menjëherë pas periudhës së stazhit apo praktikës mësimore në institucionet apo kompanitë patnere me UT.	

Zhvillimi i Gjithëanshëm i Studentit	Angazhimi në mbulimin e kohës joefektive akademike të studentëve me aktivitete ekstrakurrikulare (sport, kulturë dhe shërbime komunitare) në UT	2020-2024
	Krijimin e klubeve të pavarura studentore (psh klubi i teknologjisë, i sociologjisë, i letërsisë apo klube me qëllime të ndryshme ndër-disiplinore) të cilët janë të atashuar pranë UT dhe marrin financime për organizimin e aktiveve në përputhje me objektivat e vendosura nga UT.	
	Rritjen e numrit të programeve të studimit që adaptojnë kurse bashkë-kurrikulare të shprehura në kredite të nevojshme për diplomim (psh lëndë që lidhen me leadership-in, iniciativën, inovacionin dhe vullnetarizmin).	2020-2024
	Organizimi i një qendre sportive në formën e klubeve për trajnimin dhe kryerjen e aktiviteteve të ndryshme fizike, si p.sh. kampionati i futbollit, i volejbollit, i basketbollit, i kërcimit sportiv, etj. Këto aktivitete do të shtrihen përgjatë gjithë vitit shkollor, duke i shtuar jetës studentore dimensione për formimin e aftësive sociale si atë të punës në skuadër, përgjegjësisë së fitores dhe argëtimit në të njëjtën kohë.	
	Pajisja e të gjithë studentëve me kartën e studentit dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione publike dhe private për sigurimin e uljeve të çmimit kryesisht për bileta të aktiviteteve kulturore dhe sportive por dhe shërbimeve të tjera. Ky indikator është në të njëjtën linjë me 4 urdhërat e përbashkët të MASR për këtë qëllim.	
	Krijimi i mundësisë për ngritjen e departamentit të aktiviteteve social-kulturore në nivel rektorati ose funksionimin e një departamenti të tillë si bërthamë brenda departamentit të marrëdhënieve publike.	

Programi i Posacëm i Ekselencës dhe Qendra e Ekselencës	Themelimin, vënien në punë dhe promovimin e Qendrës së Ekselencës. Prezantimin e saj në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	
	Pjesëmarrje e vazhdueshme në rrjetet ndërkombëtare të ekselencës: COIMBRA, ISEP, IAU, EUA, CUIA, EMUNI, UNIMED.	
	Programe studimi dhe laboratore të akredituar, bashkëpunim në programe që promovojnë stabilitetin dhe mirëqënien me struktura të ngjashme të vendeve të rajonit dhe më gjerë.	
	Rritjen e numrit të të regjistruarve në ciklin e tretë të studimeve nëpërmjet rekrutimit të studentëve më performues të ciklit të dytë, investimi në network (rrjetëzim) dhe bashkëpunime, rritje të numrit të kërkimeve shkencore dhe publikimeve në revista me faktor të lartë impakti, sigurimin e pranimit dhe njohjes së tyre në rajon dhe botë.	
	Rritjen e numrit të iniciativave të reja për zbulimin dhe fuqizimin e talenteve.	
e-Learning	Zhvillimin e një politike, strukture, strategjie dhe programi për implementimin e mesimdhënies duke përdorur e-Learning. Struktura e posacme do të kordinojë dhe monitorojë tërësinë e veprimtarisë e-Learning.	
	Zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve për të patur dije pedagogjike mbi e-Learning. Rritjen e numrit të profesorëve e për pasojë studentëve që zbatojnë/adaptojnë praktika e-Learning.	
	Zhvillimin e lëndëve ku metodologjia e mesimdhënies është e përzier në kurrikula që promovojnë e-Learning. Ofrimin e disa lëndëve që përcillen pjesërisht përmes e-Content; implementimin e aktiviteteve të veprimtarive e-assessment.	

	Vendosjen e kulturës e-Learning; krijimin e mënyrave për sigurimin e stimujve dhe njohjes së e-Learning; rritjen e përdorimit të saj.	
Të mësuarit gjatë gjithë jetës (Lifelong Learning)	Përmirësimin e aksesit dhe barazisë së mundësive LLL vecanërisht për grupet e nënpërfaqësuar apo disavantazhuara, rritjen e kurseve për përmirësimin e dijes dhe aftësive, rritjen e pjesëmarrjes në programet LLL përmes edukimit fleksibël dhe mësimin në distancë.	2020-2024
	Krijimin e një sistemi të dhënash për vendosjen dhe kordinimin e punës në LLL si dhe monitorimin e vazhdueshëm të praktikave dhe veprimtarive LLL.	2020-2024
Sipërmarrja	Përmirësimin dhe rritjen e aktiviteteve ndërgjegjëse për rëndësinë e sipërmarrjes, vecanërisht sipërmarrjes sociale.	
	Rritjen e hapësirave, mundësive dhe fondeve për studentët për aftësimin në sipërmarrje.	
	Rritjen e numrit të lëndëve me zgjedhje në fushën e sipërmarrjes.	
	Zhvillimin e aktiviteteve konkurruese sipërmarrëse brenda kampusit universitar. Rritjen e numrit të studentëve që marrin pjesë në përvoja biznesi brenda kampusit	
	Inkurajimin e studentëve për krijimin e sipërmarrjeve të reja (Start -Up) apo nxitjen e bashkëpunimit UT-Biznes për angazhimin e studentëve në sipërmarrje të reja.	Në vazhdimësi
	Rritjen e numrit të sipërmarrësve nga të sapo diplomuarit përmes programeve inovative me impakt të lartë.	

# Plani i Veprimit

## VIII Financat

---

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet kryesore të integritetit për të arritur autonominë e universitetit. Të gjithë këto elementë bëhen të matshëm dhe vlerësueshëm kur shprehen në terma ekonomikë dhe financiarë.

Komercializimi i vlerave të shtuara të UT do të ishte burimi më i mirë që do të mundësonte vetëmbështetjen financiare.

Pavarësisht se UT mbështetet kryesisht nga fondet buxhetore shtetërore, përdorimi strategjik i burimeve aktuale për të krijuar më shumë mundësi është një bazë e sigurt, duke konsideruar zhvillimet e vit pas vitshme në universitet. Megjithatë nevojitet një sistem që përmirëson vetveten duke funksionuar me targetim sipas misioneve, jo me realizime sipas alokimeve.





NR	STRATEGJIA	PLAN VEPRIMI	INDIKATORI	AFATI KOHOR
VIII.	<i>FINANCA DHE BUXHETI</i>			
	Rregullim dhe përmirësim i mënyrës së planifikimit të burimeve të financimit, si dhe të manaxhimit të fondeve të UT	Rritja e efektivitetit të përdorimit të fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit	Shpërndarja e fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit në respektim të kufinjve optimal të praktikës europiane përse i takon kërkimit shkencor, investimit infrastrukturor, kapacitetit njerëzor dhe studenteve.	Në vazhdimësi
			Optimizimin e programeve të shpenzimeve dhe aplikimi i tarifave konkurruese të shërbimeve të ofruara	Në vazhdimësi
		Krijimin e kulturës së vetvëmshëmtjes institucionale dhe rritjen e lirisë akademike, si dhe autonomisë së Universitetit duke rritur fleksibilitetin e burokracisë financiare dhe duke rritur fondet me burim nga jashtë	Rritjen e autonomisë së njësisë bazë në manaxhimin e fondeve për kërkimin shkencor dhe krijimi i llogarive bankare funksionale për secilën njësi.	2021-2022
			Decentralizim gradual të kompetencave për planifikimin dhe zbatimin e buxhetit nga Rektorati drejt Fakulteteve dhe Departamenteve. Hartimi i nënprogrameve buxhetore të detajuara për të mbështetur aktivitetin e Departamenteve. Delegimi i kompetencave ekzekutive të fondeve drejt Departamenteve për të gjitha shpenzimet me destinacion direkt që lidhen me specifikat e fushës së mësimdhënies dhe kërkimin shkencor, si materiale konsumi mësimor, mobilitetet, materialet dhe facilitetet e konferencave, botimet, abonimet, etj. të kësaj natyre. Monitorimin e këtij procesi nga Administratorët e Fakulteteve, Administratori Universitetit dhe Bordi i Administrimit.	2020-2024
		Zhvillimin e mekanizmave që do të inkurajojnë departamentet të gjenerojnë fonde përmes projekteve dhe aktiviteteve të tyre në mënyrë të pavarur për stafin dhe studentët		

		Rritjen e aftësisë së gjenerimit të fondeve të jashtme përmes konsulencave, projekteve studimore për zhvillime ekonomike sociale, projekteve të kerkim zhvillimit financiar nga fondet e posaçme qeveritare, sektori privat dhe institucionet ndërkometare	2020-2024
		Rritjen e numrit të projekteve të përfituara nga programe kombëtare me këtë qëllim si dhe "Programi H2020" dhe Erasmus+	2020-2024
		Rritja e të ardhurave përmes zgjerimit të veprimtarisë së biznesit duke përfshirë aplikimin e programeve joint-venture për përdorimin dhe manaxhimin e burimeve fizike dhe mjediseve në pronësi të tij	2020-2024
		Përlllogaritje të posaçme në buxhet për aktivitetet që stimulojnë zhvillimin e sipërmarrjes nga studentët brenda UT	2020-2024
		Studimi i mundësisë për praktikimin e forma të ndryshme të shërbimit për palë të treta kundrejt procedurave të mirë përcaktuara	Në vazhdimësi
	Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies mbi administrimin e fondeve të UT	Publikimin në faqen zyrtare të internetit të universitetit në mënyrë periodike të fondeve të alokuara për secilin fakultet dhe department lidhur me veprimtarinë dhe kërkimin shkencor	Të paktën një herë në vit.
	Fondet e alokuara për stafin dhe studentët që kanë përfituar trajnim brenda dhe jashtë vendit bëhen publike, për aq sa lejon legjislacioni për administrimin e të dhënave personale	Të paktën një herë në vit.	

ME UT, PËR UT  
**VIZION & INTEGRITET!**

**VOTO KOZETA SEVRANI**

